



Shpallje interesi

për

Trajnerë me përvojë dhe module

të

Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional

TERMA REFERENCE (TOR)

Tiranë, 2025



I. Prezantim me “Qendrën Shkolla e Drejtorëve të I.A.P.”/Center for School Leadership (CSL)

“Qendra Shkolla e Drejtorëve të I.A.P.” është themeluar në vitin 2018 si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) me qëllim mbështetjen e zhvillimit profesional të drejtorëve/nëndrejtorëve në detyrë dhe aspirantë; mësuesve të institucioneve arsimore parauniversitare publike ose private, duke administruar trajnimin e detyrueshëm, procesin e certifikimit dhe ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme profesionale në vendin e punës.

“Qendra Shkolla e Drejtorëve të I.A.P.” është e përkushtuar të përgatisë drejtues dhe mësues të aftë, duke ndërtuar kapacitetet e tyre udhëheqëse profesionale dhe menaxheriale përmes programesh të një cilësie të lartë dhe të trajnimit të tyre. “Qendra Shkolla e Drejtorëve të I.A.P.” ka në vizionin e saj “Shkolla me drejtues me aftësi bashkëkohore”, të cilët ndikojnë pozitivisht në mjedisin shkollor dhe rrisin drejtpërdrejt cilësinë e arsimit.

Detyrat kryesore të Shkollës së Drejtorëve janë:

- Zhvillimi i kurrikulave si dhe akreditimi nga ASCAP apo Institucione Ndërkombëtare të Akreditimeve për programet e Trajnimeve të Detyrueshme Përgatitore për arsimin parauniversitar dhe atë të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional ofruar nga Shkolla e Drejtorëve
- Zhvillimi, udhëheqja dhe monitorimi i procesit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtorët/nëndrejtorët dhe aspirantët.
- Kryerja e procesit të testimit dhe pajisja e të gjithë kandidatëve të kualifikuar me një certifikatë të vlefshme kombëtare dhe ndërkombëtare në mënyrë që të kualifikohen për një pozicion drejtues në shkollë.
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucione të tjera arsimore në Shqipëri për të përmirësuar politikat dhe standardet e drejtimit të shkollës.
- Vlerësimi periodik i nevojave për trajnim dhe ofrimi i kurseve të vazhdueshme të zhvillimit profesional për drejtorët e shkollave.
- Të udhëheqë dhe zhvillojë kërkimin shkencor për zhvillimin profesional të drejtorit të shkollës dhe të kryejë studime përkatëse në terren.
- Zhvillimi i projekteve që mbështesin cilësinë e ofrimit të shërbimit në institucionet e arsimit parauniversitar në Shqipëri.
- Bashkëpunimi me institucione të ngjashme ndërkombëtare.



II. Prezantim me programin e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (CPD).

- ✓ Në vijim të udhëzimit nr. 16, dt. 22.07.2024 për “Organizimin dhe funksionimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” (*shtojca 1*),
- ✓ Udhëzimit nr. 17, dt. 22.07.2024 për “Kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë” (*shtojca 2*),
- ✓ dhe urdhërit nr. 157, dt. 23.09.2024 për “Miratimin e udhëzuesit për procedurat dhe për kriteret e akreditimit dhe njohjes së aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për punonjësit arsimorë” (*shtojca 3*),

“Qendra Shkolla e Drejtorëve të I.A.P” shpall thirrjen e hapur për propozime nga ekspertë me përvojë për të zhvilluar një sërë modulesh inovative dhe në koherencë me strategjinë kombëtare të arsimit për arsimin parauniversitar në Shqipëri. Aktualisht, “Qendra Shkolla e Drejtorëve të I.A.P” ofron 33 module të akredituar me 10 kredite.

Qëllimi i kësaj thirrje është të rrisë gamën e trajnimeve që institucioni ynë ofron e për rrjedhojë kapacitetin drejtues për përmirësimin e shkollave, grupin e drejtuesve potencialë dhe aspirantë të shkollave për të ardhmen, si dhe të rrisë pritshmëritë dhe performancën në të gjithë sistemin arsimor shkollor Shqiptar.

Secili modul për të cilin aplikoni duhet të adresojë tematika të rëndësishme për përmirësimin e praktikave pedagogjike dhe arsimore. Propozimet është e preferueshme por jo e detyrueshme të përqendrohen në një ose më shumë nga fushat e mëposhtme:

- Zhvillimi i kompetencave digjitale dhe përdorimi i teknologjisë në klasë.
- Promovimi i gjithëpërfshirjes në arsim.
- Përmirësimi i menaxhimit dhe lidërshiptit në shkollë.
- Edukimi për qëndrueshmërinë dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Menaxhimi i klasës dhe Lidërshipi
- Zhvillimi i aftësive socio-emocionale
- Përfshirja e Prindërve dhe Komunitetit
- Prindërimi
- Mësim i bazuar mbi aplikacione
- Eksplorimin e mësimi të personalizuar në bazë të nevojave specifike



- Iniciativa Mësues-Nxënës
- Integrimi i realitetit virtual në mësimdhënie
- Mirëqënia
- Anti-bullizmi
- STEM & Inteligjenca Artificiale

III. Grupet e synuara

Qëllimi i këtij programi është të ofrohet në shkollat në të gjithë vendin duke përfshirë grupet e mëposhtme:

- Mësuesit dhe edukatorët e shkollave dhe kopshteve.
- Drejtorët e rinj (me përvojë deri në pesë vite në drejtim) në arsimin Parashkollor dhe Para-Universitar.
- Drejtorë me përvojë të lartë (ata me më shumë se 5 vite përvojë në drejtim) në arsimin Parashkollor dhe Para-Universitar.

IV. Përmbajtja e modulit të trajnimit

Në mbështetje të **urdhërit nr. 157, dt. 23.09.2024** për “Miratimin e udhëzuesit për procedurat dhe për kriteret e akreditimit dhe njohjes së aktiviteteve të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për punonjësit arsimorë” (*shtojca 3*), informacioni i mëposhtëm është i nevojshëm të përfshihet në formën e aplikimit:

1. Lloji i trajnimit
2. Titulli i programit të trajnimit
3. Tema/tema e modulit
4. Numri i orëve të modulit të trajnimit
5. Numri i seancave dhe tema e çdo seance
6. Përfituesit e trajnimit
7. Rezultatet e pritshme



8. Përshkrimi i përmbajtjes

9. Metodologjia:

- Metodat gjatë trajnimit
- Mjetet mësimore
- Detyrat për kursantët
- Literaturë e rekomanduar për kursantët

10. Testet (pre dhe post-test)

11. Bibliografia

V. Kualifikimi i nevojshëm i trajnerit / ekspertit:

Ekspertët e interesuar duhet të:

- Të ketë minimumi gradën shkencore 'Doktor' në fushën e edukimit.
- Të ketë formim profesional dhe kontribute në fushën e drejtimit dhe të menaxhimit të arsimit parauniversitar të dëshmuara me certifikata, botime, artikuj si dhe eksperiencë në mësimdhënie në këtë fushë;
- Të njohë mirë legjislacionin arsimor parauniversitar që ka të bëjë drejtpërdrejt me veprimtarinë e drejtuesit / mësuesit të arsimit parauniversitar dhe/ose parashkollor dhe që lidhet me zhvillimin e vazhdueshëm profesional;
- Të ketë të paktën 10 (dhjetë) vite eksperiencë pune si lektor / trajner ose specialist në fushën e edukimit;
- Përparësi kanë trajnerët që zotërojnë një gjuhë të huaj evropiane (gjuha angleze e preferuar).
- Të ketë eksperiencë të ngjashme trajnimesh në fushën e edukimit dhe lidhshmëri në arsimin parauniversitar dhe / ose parashkollor.

VI. Dokumentacioni i nevojshëm

Ekspertët e interesuar duhet të paraqesin listën e dokumenteve të kërkuara për propozimin si më poshtë:



- CV të detajuar të ekspertit/trajnerit që theksojnë përvojën e ngjashme
- Diploma dhe certifikata;
- Tre kontakte për referenca;
- Kontrata dhe/apo links për botimet dhe/ose materialet e tjera përkatëse që japin informacion lidhur me përvojën e aplikantit.
- Aplikimi për çdo modul të programit, sipas *shtojcës nr. 4* bashkangjitur Termave të Referencës.
- Propozimi metodologjik dhe përmbajtësor i programit, Syllabus, bazuar në Termat e Referencës.
- Metoda e Vlerësimit / Post-testit për pjesëmarrësit për çdo modul.

VII. Oferta financiare

Pagesa për orën e angazhimit/trajnimit është 2,500ALL/orë (bruto) për trajnimet në klasë / online. Në rastet kur trajnimi do të mbahet në klasë, jashtë qytetit të Tiranës, kostot e transportit do të mbulohen nga “Qendra Shkolla e Drejtoreve të I.A.P”.

VIII. Konsiderata etike dhe konfidencialiteti

Në rast se moduli i propozuar prej trajnerit miratohet për akreditim nga ASCAP pas kërkesës së “Qendrës Shkolla e Drejtoreve të I.A.P” në bashkëpunim me trajnerin, e drejta e pronësisë intelektuale për materialin e dorëzuar do t’i transferohet Shkollës. Megjithatë, Shkolla garanton se, në rast se ju, si trajner, dhe moduli i propozuar nuk përzgjidheni, materiali i dorëzuar do të trajtohet në mënyrë tërësisht konfidenciale dhe nuk do të përdoret nga Shkolla e Drejtoreve në asnjë rrethanë. Të gjithë modulet e akredituar mbeten pronë intelektuale e “Shkollës së Drejtoreve”, e cila sipas nevojës mund t’i përditësojë, përshtasë dhe modifikojë. Ripërdorimi i materialeve nga trajnerët do të kërkojë miratimin formal dhe me shkrim të “Shkollës së Drejtoreve”.

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në adresën trajnime@csl.edu.al, deri më datë 15 Maj 2025 me subjekt “Thirrje për propozime – module ZHVP”. Në e-mailin e dërguar duhet të bashkëlidhen dokumentat e kërkuara (formatet në shtojcat bashkëlidhur).



Shtojca nr.1



4711-1-Udhezim-Nr
16-date-22072024-P

Shtojca nr.2



Udhezuesi-i-akredit
imit-i-te-aktiviteteve

Shtojca nr.3



Udhezuesi_i_akredi
timit_nr. 157 dt. 23.0



Shtojca nr. 4

FORMATI I APLIKIMIT PËR NJË MODUL

1. Lloji i trajnimit

Trajnim i drejtpërdrejtë	
Trajnimi nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime	
Trajnimi nëpërmjet internetit	

Në tabelë shënoni me “V” formën e trajnimit që agjencia ofron.

2. Titulli i programit të trajnimit (Vetëm kur moduli përfshihet në një program trajnimi)

3. Tema e modulit

4. Numri i orëve të modulit të trajnimit.

5. Numri i seancave dhe tema e çdo seance.

6. Përfituesit nga trajnimi.

Përfituesit e mundshëm nga trajnimi janë:

Drejtore të institucionit arsimor.

Tregoni nivelin e institucionit arsimor (parashkollor, fillor, arsimi i mesëm i ulët, bazë, arsimi mesëm i lartë)

Kur është drejtor i arsimit të mesëm të lartë, specifikoni a është gjimnaz, arsim profesional apo shkollë e mesme e orientuar.

Mësues.

Përcaktoni nivelin e tij arsimor. Për arsimin e mesëm, tregoni lëndën.

Kur për arsimin fillor, tematika e trajnimit ka të bëjë me një fushë të nxëni, tregojeni atë.



7. Rezultatet e pritshme.

Përshkruani se çfarë duhet të jenë në gjendje të dinë dhe të bëjnë të trajnuarit në përfundim të modulit (kompetencat e tyre profesionale).

Çdo rezultat duhet të jetë i matshëm.

Një rezultat paraqitet me një frazë.

8. Përshkrimi i përmbajtjes.

Përmbajtja e modulit përshkruhet përmbledhtas. Ju do t'i përgjigjeni pyetjes “Çfarë përmban moduli?”

Përshkrimi të jetë 1/3 deri në ½ e një faqe A4, e shkruar në kompjuter me Times New Roman.

9. Metodologjia.

1. Te metodologjia përshkruhet përmbledhtas si trajneri do ta zhvillojë përmbajtjen dhe si pjesëmarrësit në trajnim do të arrijnë rezultatet e pritshme. Metodologjia përmban këto elemente:

a) Metodot gjatë trajnimit

Për trajnimin e drejtpërdrejt

Përshkrimi i konkretizuar i metodave gjatë trajnimit, si: leksioni, demonstrimi, debati, diskutimi, eksperimentimi, puna e pavarur individuale, puna në grupe të vogla, puna me të gjithë klasën, loja me role, vizita studimore, biseda me të ftuar etj.

Për trajnimin nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime

Konsultim nëpërmjet takimeve me të trajnuarit ose/dhe nëpërmjet internetit. Përshkrim i konkretizuar i metodave mbizotëruese në të dyja format e konsultimeve.

b) Përshkrimi i konkretizuar i mjeteve mësimore.

- Vizuale (fotografi, piktura, diafilma, diapozitivë, flipçart, grafikë, diagrama etj.)
- Auditive (magnetofoni, kasetofoni, radioja etj.)
- Audovizuale (filmi, televizioni, videoja etj.)
- Etj.

c) Detyra për të trajnuarit, për t'i kryer gjatë ose/dhe pas modulit, janë punë individuale ose në grup për përgatitje të detyrave tematike, rasteve studimore, projekteve, esseve etj.

d) Literatura e rekomanduar për të trajnuarit për t'u shfrytëzuar gjatë dhe pas modulit.



Literatura përmban jo vetëm titujt e librave ose të shkrimeve por, edhe ekstrakte të tyre dhe, numrin e faqeve dhe cilat faqe duhet të studiojë i trajnuari.

Metodologjia të jetë 1 (një) deri në 1,5 faqe A4 e shkruar në kompjuter me Times New Roman.

10. Testet

Tre teste për provimin e modulit bashkë me përgjigjet e tyre.

Një test parashikohet të zhvillohet nga i trajnuari për rreth 60 – 90 minuta dhe synon të verifikojë përmbushjen e rezultateve të të nxënit. Në çdo test shënohet dhe kohëzgjatja e tij.

11. Bibliografia kryesore e përdorur për të hartuar modulin.

Vendosni një numër të kufizuar botimesh (libra, shkrime ose nga interneti)

Për çdo produkt profesional shkruhet:

- Emri mbiemri i bashkautorëve
- Titulli
- Institucioni botues ose organizues
- Viti